[Shqiptarja.com]

E shtunë 8 Nëntor 2025 - Përditësimi i fundit 22:12

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LAJME TË MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PKË E ZZJË SONDAZHE

POP 5

Kushtetuesja e la në detyrë Erion Veliajn, aktorja Olta Gixhari: Lali kthehu, Tirana është qelbur

Viti 2025, me i vetëm për ashtërsi vaut, 93 një shtetas i Kosovës ka vdekur nga mërzitja

Alban Daci: Libri Zengjarë edhe unë, si shumë shqiptarë 1991 njoes bë përdhunimin i Gjyrkes dëshi Sara

Ulet kufiri për punonë sakt, dyt do furë bë ndërtimin e Kullës Shtëpisë me terminale

Polemika, VKM dhe "mosos di pritje" shkaktojnë vonesë punimeve dhe krisma e vetëm, gjatë një qytetin i Gjirokastrës

Kronikë

Do ia shiste krimit, ish-ushtaraku kapet me 4 pistoleta e municione, kamuflohej si taksist! Pjesë e grupit që do vriste 'Rrumin e Shijakut' (VIDEO)

Altin Celami është arrestuar edhe më herët, në 2022-shin, i dyshuar se furnizonte me armë me armë grupin e Kasandër Noçës për disa atentate. Mbetet e paqartë se si është lirua ish-ushtaraku 46-vjecar. Hetuesit po përpiqen të zbulojnë se për cilat grupe ishin destinuar armët që ia gjetën në taksinë e kamufluar.

Sokol Dema
8 Nëntor, 09:19 | **Përditësimi: 8 Nëntor, 16:02**

Share

TIRANË - Pas disa javësh në vëzhgim, për të vërtetuar veprimtarinë kriminale, forcat e policisë ndaluan një automjet, një taksi që prej kohësh kamuflohej si e tillë për të furnizuar me armë grupet kriminale. Jo rastësisht, operacioni u kodua "Eksperti i Armëve". Në timon të taksisë së ndaluar te "Rruga e Dibrës", ishte Altin Celami, i cili u arrestua në kushtet e flagrancës. 46-vjecari, ish-ushtarak i repartit të Pezë Helmësit, prej kohësh zgjodhi që përvojën e fituar nën radhët e ushtrisë, ta ushtrojë në anën tjetër, në favor të krimit.

Gjatë kontrollit të makinës, në një çantë krahu, agjentët e Anti-trafiqeve dhe Komisariatit nr. 4 i gjetën 2 pistoleta, ndërsa në një xhep të fshehtë poshtë qafores së xhupit një sasi kokaine e mbështjellë me qese të bardhë.

Nga një kontroll edhe në banesën e tij, ish-ushtarakut iu gjetën edhe 2 pistoleta të tjera dhe pjesë të ndryshme armësh, në një qese që e mbante në rafton e robave. Sendet e jashtëligjshme dhe makina e loguar si taksi për t'i shpëtuar kontrolleve të bluve, u sekuestruan.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Kushtetuesja e la në detyrë Erion Veliajn, aktorja Olta Gixhari: Lali kthehu, Tirana është qelbur

Altin Celami dyshohet se këto armë i siguronte për të furnizuar grupe të ndryshme që të përdoreshin në ngjarje kriminale. Ato u dërguan në laborator për ekspertim, për të parë nëse janë përdorur në krime në të shkuarën.

> *"Në kuadër të operacionit u arrestua në flagrancë, në Rrugën e Dibrës, shtetasi A. C., 46 vjeç, banues në Tiranë, teksa drejtonte automjetin tip taksi.*
>
> *Gjatë kontrollit fizik, të automjetit dhe të banesës, iu gjetën 4 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, të cilat nga hetimet dyshohet se do t'iu shiteshin grupeve kriminale, lëndë narkotike kokainë dhe pjesë të ndryshme arme të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale sëbashku me automjetin. Punohet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale", njoftoi policia.*

Një skemë të njjashme në shtrbim të grupeve të rrezikshme, ish-ushtaraku e ka në CV-në e tij kriminale. Në tetor të vitit 2022, Altin Celami është arrestuar si pjesë e një grupi kriminal, të cilit i siguronte armë për të kryer vrasje me pagesë.

Në atë kohë, 46-vjecari u arrestua bashkë me disa anëtarë të një grupi që kishin bërë disa krime të rënda. Ishin dëshmitë e vëllezërve Indrit dhe Gentian Beqiraj që zbardhën disa ngjarje kriminale. Një prej të cilave me porosi nga Kasandër Noga për vrasjen me pagesë të kundërshtarët e tij, Geron Hasanbelliu, ngjarje në të cilën gabimisht në një lokal në "Don Bosko" u vra gabimisht Erion Çela. I njëjti grup, sipas rrëfimeve të vëllezërve, kishte planifikuar edhe ***eliminimin fizik të Aleksandër Lahos***, i njohur si Rrumi i Shijakut.

Edhe pas daljes nga burgu, në rrethana që mbeten të paqarta, ish-ushtaraku nuk e harroi zakonin e vjetër për t'i gjetur armatime grupeve kriminale.

K.M/E.H/Shqiptarja.com

TAG: kasandër noga | trafik armesh | Tirana | altin celami | rrumi i shijakut | aleksander lahu | indrit beqiraj | gentian beqiraj | Erion Çela

Komentio

Komente

Jeton KALLOJER Fadil Gjoleka: 08/11/2025 10:39
Mereni maskararin futeni në burg e mos e nxirni më në qarkullim se është kontigjent mbeturin e jashtqitje e kombit. Ky njeri vetëm në burg e ka vëndin.
Përgjigju

Muci: 08/11/2025 11:59
Shume mire e ke ti, po ndonje lek a do kape opgj, prokuroriz gjykatesi?!

Etan: 08/11/2025 09:54
Drejtesia qe duam, arrestuar ne 2022 per grup kriminal vrasje me pagese dhe pas 3 vitesh qenka i lire...nje katunar ne mal e kapin me pushke 10ce se mbrohet nga njeriti dhe arinjtë se eshte coban e denojne me 7vjet, keta ne mes te Tiranes me arme ne brez dalin brenda vitit.
Përgjigju

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni skemën e re të rritjes së pensioneve?

6 Nëntor, 09:44

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e kuptoj

Lajme të tjera

Superliga/ Tirana prek fundin, Vora e mposht 0-2 në 'Selman Stërmasi'! Bardhebluët braktisen edhe nga tifozët
8 Nëntor, 16:00

Bileta e autobusit në Kamëz u rrit në 50 lekë, Partia e Lirisë thirrje: Anulojeni, po rëndoni xhepat e qytetarëve
8 Nëntor, 13:45

Avokati i Trump, Kasowitz: Erion Veliaj priti 9 muaj për të folur 9 minuta në Gjykatë dhe rimori detyrën e kryebashkiakut
8 Nëntor, 12:37

'Furnizonte' Anglinë me drogë të klasit A, pranga 41-vjecarit në Rinas! Arrestohen edhe dy të tjerë
8 Nëntor, 12:28

Plagosi me armë një person pranë komisariatit të policisë, ekstradohet nga Britania pas 7 vitesh nipi i ish-deputetit të PDIU-së
8 Nëntor, 10:30

Autobusi turistik në Tiranë, Rama: Shëtit vizitorët dhe u tregon ngjyrat dhe gjallërinë e qytetit
8 Nëntor, 08:15

Votuan shkarkimin e Erion Veliajt/ Anëtari i Këshillit Bashkiak të PS për Report Tv: Ishte vendim i vështirë, por Anuela Ristani dështoi në drejtim
7 Nëntor, 18:42

Banorët e Durrësit protestë para kryeministrisë kundër projektit TID: Po na prishin shtëpitë padrejtësisht
7 Nëntor, 18:10

PD denoncon: Universiteti i Sporteve në Tiranë ofron programe studimi, diplomat e të cilëve nuk njihen
7 Nëntor, 15:50

U la në detyrë, Veliaj: Vendim për demokracinë shqiptare! Burimet: Do e ankimojë masën në Kushtetuese
7 Nëntor, 13:21

Tirana e shumë problemeve pret nesër Vorën, Nuhiu: Rivalët janë kockë e fortë, duhet grintë dhe dëshirë për fitoren
7 Nëntor, 13:01

Vijon aksioni për ndërtimet pa leje në Farkë, ministrja Koçiu: Askush nuk është mbi ligjin! Ndërtuesit të kenë kujdes, objektet do të shemben (VIDEO)
7 Nëntor, 12:46

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje